Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

07.12.2020, Prishtinë,
Ref:01.09.2020\1058-2020

Vendim i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj ankesës së Vlora Krasniqi kundër Gazeta Express

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e tij të mbajtur më 24 nëntor 2020, shqyrtoi ankesën e Vlora Krasniqit kundër Gazeta Express lidhur me publikimin e artikullit me titull: "Po kërkoni produkte cilësore, unike brende botërore? Ja vendi ku mund t'i gjeni", dhe mori këtë:

V E N D I M

- Ankesa miratohet.

A R S Y E T I M I

Ankesa ka të bëjë me shkrimin e publikuar në median Gazeta Express me titull "Po kërkoni produkte cilësore, unike brende botërore? Ja vendi ku mund t'i gjeni", dhe pretendimin se shkrimi bënë shkelje të Kreut XII (Reklamat dhe sponsorizimi) të Kodit të mediave të shkruara.

Lajmi është shkruar në media online dhe objekt i kësaj ankese është teksti i shkruar, e që rrjedhimisht ankesa është e lejueshme për trajtim dhe e afatshme.

Pas leximit të ankesës dhe shqyrtimit të artikullit, KMShK gjen se ankesa është e bazuar.

Gazeta Express ka publikuar një shkrim që përmban tekstin e një kampanje të një kompanie. Lajmi është marketing, por media nuk e ka shënjuar si të tillë. Kodi i Mediave të Shkruara është shumë i qartë në këtë pjesë, media ka për obligim që të shënjojë me dallim që është material i sponsorizuar dhe duhet të tregojë nga kush sponsorizohet.

Andaj KMShK, konsideron se ka shkelje të Kodit të Mediave, Kreu XII(Reklamat dhe Sponzorizimi).

KMShK vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës